

Dr. Musli Vërbani

Mëshira

21



Planprogrami i muslimanit të vogël

Shkup, 2004

Dr. Musli Vërbani

MËSHIRA

21

Kaçanik, 2011

Autor:
Dr. Musli VËRBANI

Titulli:
MËSHIRA

Korrektura:
Burim Bunjaku

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*
Mumin Shehu

Botues: **Autori**

Shtypi:
“FokusPrint”

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

MËSHIRA

Mëshira është cilësi fisnike islame.

Mëshira është moral, i cili tregon ngritjen e lartë shpirtërore dhe pastërtinë e zemrës. Sa më shumë rritet mëshira te njeriu, aq më shumë ngritet personaliteti i tij.

Cilësi e Zotit është cilësia *“i Mëshirshëm”*. Mëshira e Zotit përfshinë çdo gjë.

Të gjitha gjallesat jetojnë prej mëshirës së Allahut. Zoti i Lartmadhëruar ia ka bërë detyrë Vetes mëshirën.

Njeri i mëshirshëm është ai, i cili ka zemrën e butë, i cili gjithmonë bën vepra të mira.

Mëshira tregon pjekurinë e njeriut dhe pastërtinë e shpirtit.

Morali i mëshirës është morali që do të bëjë dobi në Ditën e Kijametit.

Të gjitha suret në Kur'an fillojnë me fjalën “mëshirë”, me *bismilahi rrahmani rrahim*.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Allahu ka caktuar për Vetën e Tij 100 pjesë të mëshirës, prej tyre vetëm një pjesë e ka lënë në tokë, e prej asaj pjese mëshirohen të gjitha gjallesat, sa që edhe kafsha e bën vrimën për të voglin e saj, nga frika se mos i ndodhë diçka.”

Mëshira është cilësi e të gjithë pejgamberëve. Të gjithë pejgamberët kanë qenë të urdhëruar për mëshirë.

Pejgamberi s.a.v.s. është dërguar mëshirë për të gjithë botët. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

“Ty (o Muhamed) nuk të kemi dërguar për diçka tjetër, përpos mëshirë për të gjithë botët.” (El-Enbija, 107)

Zoti i Lartmadhëruar e ka pajisur zemrën e Muhamedit s.a.v.s. me dituri, urtësi, mirësi, butësi, fisnikëri, sa që e bëri njeriun më të mëshirshëm. Ja çka thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje.”
(Ali Imran, 159)

Po mos ta kishte Muhamedi s.a.v.s. cilësinë e mëshirës, njerëzit nuk do të tuboheshin rreth tij.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

“Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vie rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.”

(Et-Tevbe, 128)

Pas Muhamedit s.a.v.s. edhe sahabët janë pajisur me këtë cilësi, e edhe ne duhet të vazhdojmë rrugën e tyre, e të jemi të mëshirshëm.

Mëshira është ndjenjë e posaçme dhe zemërbutësi, dhe nuk është ngurosim i zemrës, as ashpërsi.

Nuk ka më mirë se të stolisemi me këtë cilësi fisnike.

MËSHIRA E ALLAHUT

“E kur të vijnë ty ata që i besojnë ajetet tona, thuaju: “Selamun alejkum, Zoti juaj ia ngjeshi vetes mëshirën. Kush bën prej jush ndonjë të keqe pa dije, e mandej pas asaj (të keqe) pendohet dhe përmirësohet, s’ka dyshim se All-llahu është që falë shumë dhe është Mëshirues.”

(El-En’am, 54)

Mëshira është cilësi e përhershme e Allahut:

“Dhe cakto për ne (jetë) të mirë në Dunja dhe të mirë në botën tjetër, pse vërtet jemi kthyer kah Ti. Ai (Zoti) tha: “Dënimi im është ai me të cilin e godas cilin dua, e mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (Mëshirën) do ta caktoj për ata të cilët u ruhen (mëkateve), e japin zeqatin dhe për ata që i besojnë argumentet tona.”

(El-Ea’rafë, 156)

Nga mëshira e Allahut, buron mëshira e prindërve ndaj fëmijëve, mëshira e familjarëve ndaj familjarëve, mëshira ndaj bashkëshortëve. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”

(Err-Rrum, 21)

“Zoti juaj (që meriton adhurim) është Një, All-llahu, nuk ka zot pos Atij që është mëshirëplotë, gjithnjë mëshiron.”

(El-Bekare, 163)

Në hadithin Kudsij Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Mëshira Ime dominon mbi hidhërimin Tim.”

Ajeti i parë i suretul Fatiha është: بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ – Në emër të Allahut Mëshirëbërësit Mëshiruesit.

“Ai (Jakubi) tha: “A t’ju besoj për këtë, vetëm sikurse u besova më parë për vëllain e tij (Jusufin), po All-llahu është mbrojtësi më i mirë dhe Ai është mëshirues i mëshiruesve.” (Jusuf, 64)

Mëshira e fundit do të jetë hyrja në Xhenet. Zoti i Lartmadhëruar i drejtohet Xhenetit dhe i thotë:

“Ti (xhenet) je mëshira Ime me të cilën mëshiroj kë të dua nga robërit e Mi.”

MËSHIRA NË KUR'AN

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

“Dhe cakto për ne (jetë) të mirë në Dunja dhe të mirë në botën tjetër, pse vërtet jemi kthyer kah Ti. Ai (Zoti) tha: “Dënimi im është ai me të cilin e godas cilin dua, e mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (Mëshirën) do ta caktoj për ata, të cilët u ruhen (mëkateve), e japin zeqatin dhe për ata që i besojnë argumentet tona.”

(El-Ea'rafë, 156)

“E ti thuaj: “O Zoti im, më fal e më mëshiro, se Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!”

(El-Muëminunë, 118)

“E pastaj të bëhej prej atyre që besuan, që këshilluan njëri-tjetrin për durim dhe që këshilluan për mëshirë (për ndihmë).”

(El-Beled, 17)

MËSHIRA NË SUNET

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Zoti mëshiron, nga robërit e Tij, ata që janë të mëshirshëm.”

“Ata që janë të mëshirshëm i mëshiron Mëshiruesi. Mëshironi ata që janë mbi tokë, t’ju mëshirojë Ai që është në qiell. “Mëshira është litar prej të Gjithëmëshirshmit. Kush e lidh atë, Allahu do të ndërlihet me të, e kush e ndërpret, Allahu ndërpret lidhjet me të.”

(Tirmidhiu)

“Kush nuk është i mëshirshëm ndaj njerëzve, Allahu nuk është i mëshirshëm ndaj tij.”

*(Transmeton Buhariu, Muslimi,
Tirmidhiu dhe Ahmedi)*

“Nuk do të besoni përderisa nuk mëshironi.”

“Shembulli i muslimanëve në dashuri të ndërsjellët mes vete, në harmoni mes vete dhe në mëshirë mes vete është njësoj si shembulli i trupit, që kur të rënkton një organ i trupit, atëherë tërë trupi ndien dhembje dhe rënkton.”

MËSHIRA E PEJGAMBERIT s.a.v.s.

Emër i Pejgamberit s.a.v.s. është “Mëshirë”.

Një ditë, një burrë i thotë Pejgamberit s.a.v.s.: “O i Dërguar i Allahut, lute Zotin që t’i shkatërrojë idhujtarët.” Pejgamberi s.a.v.s. i thotë:

“Vërtet, Zoti nuk më ka dërguar për të mallkuar, por për të mëshiruar.”

Ka prej tyre që e ofendojnë Pejgamberin, e thonë: “Ai është bërë vesh (beson çka dëgjon)”. Thuaj: “Ai është vesh i të mirës suaj (dëgjon të mirën dhe vepron, e jo të keqen), ai beson All-llahun (çka i thotë), u zë besë besimtarëve dhe është mëshirues për ata që besuan nga mesi juaj, e ata që nuk e lënë të qetë të dërguarin e All-llahut, ata kanë dënim të dhembshëm.

(Et-Tevbe, 61)

Pejgamberi s.a.v.s. është pejgamber i mëshirës, mëshirues i udhëzimit, mëshirues i umetit të tij, dhe mëshirues i të gjithë botëve.

MËSHIRA E PEJGAMBERIT S.A.V.S. NDAJ FËMIJËVE

Muhamedi s.a.v.s. e ka pasur një vajzë, e cila quhej Zejnebe. Pasi që Zejnebeja ishte martuar e kishte një djalë, mirëpo djali i saj sëmuret dhe ishte pranë vdekjes. Zejnebeja e lajmëron Pejgamberin s.a.v.s. Kur shkon Pejgamberi s.a.v.s. dhe e sheh foshnjën duke rënkuar nga dhimbjet dhe po vdiste, Pejgamberi s.a.v.s. filloi të qajë. Sead bin Muadhi i habitur i thotë: “A po qanë o Pejgamber i Allahut?!” Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: *“Po, o Sead, kjo është mëshirë që Zoti e vendos në zemrat e robërve të Vet.”*

IBRAHIMI A.S. ME ZJARRPUTISTIN

Në Kur'an janë përmendur 28 pejgamberë. Prej tyre nga “Ulul Azmi” (Elitës së pejgamberëve) është Ibrahim a.s. Ai i donte udhëtarët, musafirët, dhe çdo herë kur shihte ndonjë kalimtar i jepte ushqim.

Një ditë e takon një kalimtar që ishte zjarrputist. Kur Ibrahim a.s. e ndez zjarrin, i moshuari i përulet zjarrit duke e adhuruar. Kur e kuptoi Ibrahim a.s. se ai ishte adhures i zjarrit, me të shpejtë i bërtet dhe e dëbon nga vendbanimi i vet duke i thënë: “Po si ushqehesh me të mirat e Zoti dhe adhuron zjarrin?! Ti nuk e meriton të ushqehesh me ushqimet që na ka dhënë Zoti.” Pasi i moshuari del jashtë, shkon Xhibrili te Ibrahim a.s. dhe i thotë se Zoti të thotë: “Unë e kam duruar atë për 60 vjet, kurse ti nuk e durove vetëm për një orë?!” Atëherë Ibrahim a.s. del duke e kërkuar plakun dhe e takon. Pasi e përshëndet, e fton të hante darkë tek ai. Plaku i thotë: “Më parë më dëbove, e si është e mundur, tani po më fton përsëri?” Ibrahim a.s. i thotë se Zoti më ka qortuar me sjelljen time ndaj teje.

Kur plaku e kuptoi, i thotë: “Një Zot i tillë e meriton të adhurohet”, dhe beson në Zotin.

ISLAMI FE E MËSHIRËS

Udhëheqësi i muslimanëve, Salahudin Ejubi qëndronte në shatorin e tij. Një grua jomyslimane dëshironte të hynte aty, mirëpo rojet nuk e lejonin. Ajo filloi të qajë. Salahudin Ejubi e dëgjon zërin e saj duke qarë dhe urdhëron rojet që ta lejonin të hyjë brenda. Ajo kur hyri brenda i thotë: “Burri im është robëruar në luftë, ndërsa hajnat më kanë kidnapuar birin tim të vogël.

Salahudin Ejubi ndjen dhembje, zemra e tij u trondit. Për këtë arsye urdhëroi që burri i saj i robëruar të lirohet, ndërsa ushtarët tjerë i urdhëroi që t’ia gjejnë birin e saj.

Ushtarët pas një hulumtimi e gjejnë djalin e saj dhe ia sjellin. Ajo u gëzua pa masë. Salahudin Ejubi i thotë asaj: *“Morali islam na obligon që të jemi të mëshirshëm për të gjithë njerëzit.”* Gruaja thotë: “Po sa fe e mirë na qenka kjo fe, e cila urdhëron për mëshirë dhe ndihmë ndaj të dobëtëve.” Pastaj ajo dhe burri i saj e pranojnë islamin pasi që e kuptuan se Islami është fe e mëshirës.

MËSHIRA NDAJ NJERËZVE

Muhamedi s.a.v.s. ka qenë dhe është njeriu më i mëshirshëm në fytyrën e tokës. E ka pasur zemrën e butë, kraharorin e gjerë.

Një ditë, një njeri i thotë Pejgamberit s.a.v.s.: “O i Dërguar i Allahut, lute Zotin që t’i shkatërrojë idhujtarët.” Pejgamberi s.a.v.s. ia ktheu:

“Zoti nuk më ka dërguar për të mallkuar, por për të mëshiruar.”

Zoti i Lartmadhëruar në hadith kudsij ka thënë:

“Unë jam Zoti dhe Unë jam Mëshiruesi, kam krijuar lidhjet e gjakut dhe emrin e saj e kam emëruar nga cilësitë e Mia. Kush i mban afër njerëzit e fafesisit, Zoti e mban atë, e kush i largon ata, Zoti e largon atë.”

MËSHIRA NDAJ PRINDËRVE

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an na ka urdhëruar që të lutemi për mëshirë ndaj prindërve, ku thotë:

“Dhe thuaj: Zoti im! Mëshiroji ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël.”

(El-Isra, 24)

Që nga lindja e fëmijës, lind ndjenja e mëshirës së ndërsjellët fëmijë-prindër dhe prindër-fëmijë.

Nënës i qanë zemra kur qanë fëmija, prindi pikëllohet kur fëmija nuk është i lumtur, ata e ndajnë kafshatën e gojës, për fëmijët. Për këtë arsye edhe Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Zoti yt të ka obliguar që të mos adhuronit askënd tjetër përpos Tij, dhe të silleni mirë me prindërit.”

(El-Isra, 24)

Pra, adhurimi ndaj Allahut është i ndërlidhur me respektin dhe mëshirën ndaj prindërve.

NËNA ME FOSH NJËN E SAJ

Në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. një grua kishte qenë e robëruar. Kur e sheh një fëmijë të vogël në mesin e robërve, e përshkoi ngrohtësia dhe dashuria për të, ndjente mallëngjim dhe dashuri për të, edhe pse nuk e njihte. Pejgamberi s.a.v.s. kur e pa këtë ngjarje i pyeti sahabët:

“Çka mendoni, a mundet kjo grua të hedhë fëmijën në zjarr?”

Sahabët i përgjigjen: “Jo!”

Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. u tha:

“Vërtet Allahu i Madhëruar është më i mëshirshëm ndaj robërve të vet se sa kjo grua ndaj fëmijës.”

MËSHIRA NDAJ FËMIJËVE

Njëra prej vajzave të Pejgamberit s.a.v.s. i dërgon të fala Pejgamberit s.a.v.s. dhe i tregon se një fëmijë i saj ka vdekur.

Pejgamberi s.a.v.s. i përcjell selamin dhe i thotë:

“Vërtet Allahu jep dhe merr. Çdo gjë është e caktuar te Ai për afatin e vdekjes, për këtë arsye duro dhe llogarit në shpërblim.”

Për së dyti e fton. Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. shkon dhe e merr fëmijën e saj në kraharor dhe sytë e tij i mbushen me lot. Sead bin Ubadete r.a. i thotë: “O i Dërguar i Allahut, ç’është kjo, pse po qanë?!” Pejgamberi s.a.v.s. i thotë:

“Kjo është mëshira, të cilën Allahu e ka caktuar të jetë në zemra të robërve të Tij. Vërtet Allahu prej robërve të Tij i mëshiron të mëshirshmit.”

Ekrea bin Habisi ka qenë shok i Pejgamberit s.a.v.s. Ai i kishte dhjetë fëmijë dhe asnjërin prej tyre nuk e kishte puthur asnjëherë. Një ditë prej ditëve e sheh Pejgamberin s.a.v.s. duke e puthur nipin e tij, Hasanin r.a. - djalin e Alijut r.a. Në atë çast, Ekrea bin Habisi habitet dhe i habitur e pyet: “A kështu i puthni fëmijët tuaj?! Po ne nuk i puthmi asnjëherë.” Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. befasohet për ashpërsinë dhe ngurtësinë e tij me fëmijët e tij dhe fillon ta qortojë me një qortim të rreptë:

“Çfarë mund të bëjë atëherë kur Allahu nga zemra jote e ka hequr mëshirën.”

Muhamedi s.a.v.s. ia tërheq vërejtjen dhe i thotë:

“Kush nuk mëshiron nuk mëshirohet.”

MËSHIRA NDAJ JETIMËVE

Jetimi është pjesëtar i shoqërisë, atij i ka humbur prindi që nga vegjëlja dhe nuk ka udhëzues, kujdestar dhe mbikëqyrës. Nëse ai lihet anash, dëmtohet shoqëria në përgjithësi. Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë Pejgamberit s.a.v.s.:

“Ndërsa, sa i përket jetimit, mos i bërtit.” (Ed-Duha, 9)

Përkujdesjen dhe mirësjelljen ndaj jetimit Zoti i Lartmadhëruar e konsideron cilësi të besimtarëve ku thotë:

“Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimit) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë e vështirë. Po Allahu i ruajti ata prej sherrit të asaj dite dhe u dhuroi shkëlqim në fytyra e gëzim të madh.”

(El-Insan, 8-12)

Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Unë dhe përkujdesësi i jetimit do të jemi në xhenet së bashku (kështu, duke bërë me shenjë), duke i bashkuar dy gishtat e dorës.”

Një njeri është ankuar te Pejgamberi s.a.v.s. se është i ngurtë në zemër. Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. i thotë:

“Lëmoje kokën e jetimit dhe ushqejti të varfrit.” (atëherë do të të zbutet zemra).

“(Të mendoni) Për këtë botë dhe për botën tjetër. Dhe të pyesin ty për jetimët. Thuaj: “Po t’i ndihmoni në punët e tyre është më mirë, e nëse i përzieni (pasurinë e tyre me tuajën), ata janë vëllezërit tuaj. All-llahu di të dallojë qëllimkeqin nga qëllimmirin. E sikur të dëshironte All-llahu do t’ju rëndojë. All-llahu është më i fuqishmi, më i urti.”

(El-Bekare, 220)

“Ata që e hanë pa të drejtë pasurinë e jetimëve, në të vërtetë ata hanë atë që mbush barkun e tyre zjarr dhe do të futen në zjarrin e xhehennemit.”

(En-Nisa, 220)

“A e ke parë ti (a e sheh) atë, që përgënjeshtroi përgjegjësinë dhe llogarinë në botën tjetër? Po ai është që e përzë në mënyrë të vrazhdë jetimin.”

(En-Nisa, 220)

MËSHIRA DHE KUJDESI NDAJ JETIMËVE

Musa a.s. ka qenë peygamber. Gjatë një udhëtimi është shoqëruar me Hidrin a.s. Në atë udhëtim ka mësuar çështje shumë interesante prej Hidrit pasi që Hidrit a.s. i është dhënë cilësia e mëshirës dhe dituria prej Allahut.

Duke udhëtuar Musa a.s. dhe Hidri arrin në një qytet. Aty kërkojnë ushqim dhe vendstrehim, mirëpo banorët ishin koprrac, ata as nuk u japin ushqim dhe as nuk i vendstrehojnë.

Duke kaluar në anën tjetër të qytetit e shohin një mur të vjetër, i cili ishte duke u rrëzuar, e që rrëzimi i atij muri do t'i dëmtonte kalimtarët dhe do të rrezikonte gjendjen e banorëve. Hidri a.s. i thotë Musaut a.s. që ta riparojnë atë mur. Pasi që e riparojnë Musa a.s. i thotë: “Po pasi e riparuam të kërkojmë kompensim.” Mirëpo Hidri i thotë: “Jo, nuk do të kërkojmë kompensim, sepse murin e kam riparuar për arsye tjetër. Arsyeja është se nën mur ishte vendosur një thesar i dy jetimëve, e rrëzimi i atij muri do të zbulonte thesarin e tyre, e atë do ta merrnin ai popull koprrac. Kështu që pas riparimit, fëmijët jetimë do të rriten, e pasi që të rriten Zoti do t’ua mundësojë atyre dy jetimëve që të arrijnë deri te zbulimi i atij thesari. Për këtë ngjarje Zoti i Lartmadhëruar në Suretu El-Kehf thotë:

“Vazhduan të shkojnë deri sa arritën te banorët e një qyteti që prej tyre kërkuan t’u japin ushqim, po ata nuk deshën t’i pranojnë si musafirë (e as t’i ushqejnë), e ata të dy gjetën aty një mur që gati po rrëzohej, e ai e drejtoi atë (murin). (Musai) Tha: “Sikur të kishe dashur do t’u merrje shpërblim për këtë!”

Ai (i diijshmi) tha: “Tash ka ardhur koha e ndarjes mes meje dhe mes teje, e unë do të tregoj për domethënien e asaj që nuk munde të keshë durim!”

Sa i përket anijes, ajo ishte pronë e do të varfërve që veprojnë në det, e unë desha ta bëj atë me të meta, ngase para tyre ishte një sundues që grabiste çdo anije (të aftë - pa të meta).

Sa i përket djaloshit, dy prindërit e tij ishin besimtarë, e u frikësuan se ai do t'i shpie ata të dy në humbje e në mosbesim.

Deshëm që Zoti i tyre t'u japë në vend të tij një më të mirë se ai dhe më të afërt në respekt dhe në mëshirë (ndaj prindërve).

Përsa i përket murit, ai ishte i dy djelmoshave jetima të atij qyteti, e nën të ata kishin një thesar (ari) dhe babai i tyre ka qenë njeri i mirë, e Zoti yt dëshiroi që ata dy (jetima) ta arrijnë pjekurinë e vet dhe ta nxjerrin ata vetë thesarin e tyre. Kjo ishte mëshirë e Zotit tënd (ndaj tyre). Dhe unë nuk e punova tërë atë sipas bindjes sime (po sipas udhëzimit të Zotit). Ky, pra, është sqarimi i asaj për të cilën nuk munde të kesh durim!”

(El-Kehf, 77-82)

DUAJA E JETIMIT

Një pijanec dehej dhe për çdo dit mëkatonte. Një ditë të ftohtë dimri përderisa kalonte nëpër një rrugicë, aty she një fëmijë duke qarë prej urie, e që dridhej. Pasi që bisedon me të e kuptoi se ai ishte jetim. Jetimi e impresionoi kështu që i dha ushqim, e hoqi pallton e tij dhe ia veshi që ta mbrojë nga të ftohtit dhe shkon në shtëpi ku bie në gjumë të thellë.

Në gjumë sheh ëndërr se ka ndodhur Dita e Kijametit, njerëzit jepnin llogari. E Sheh veten e tij se si melekët e tërhiqnin për ta shpjerë në zjarr të Xhehenemit. Mirëpo gjatë rrugës e sheh se si jetimi lutej që atij t'i falen gabimet. Allahu ia pranon lutjen jetimit dhe urdhëron melekët që mos ta dënojnë pasi që ishte sjell mirë me jetimin. Njeriu zgjohet nga gjumi, kur e sheh veten në shtrat kërkon falje nga Allahu dhe e la alkoolin dhe mëkatet dhe vendos që gjithmonë t'u ndihmojë jetimëve.

MËSHIRA NDAJ TRUPIT

Njeriu është i mëshirshëm ndaj trupit të tij kur largohet nga gjërat që e dëmtojnë shëndetin e tij, si alkooli duhani etj, etj.

Si mund të jetë njeriu i mëshirshëm ndaj të tjerëve, kur nuk është i mëshirshëm ndaj vetes së tij?!

MËSHIRA NDAJ KAFSHËVE

Në një hadith, Pejgamberi s.a.v.s. tregon:

“Përderisa një njeri udhëtonte, e kap etja, e gjen një pus të thellë, zbret në të dhe pi ujë. Pastaj del nga pusi, kur e sheh një qen duke gulçuar, i cili nga etja hante bimë. Njeriu thotë: “Këtë qen e paska kapluar etja, sikur që më kishte kapluar mua! Andaj zbriti në pus, e mbushi këpucën e vet me ujë, pastaj e kapi për gojë, e ngriti dhe i dha ujë qenit. Këtë veprim Allahu ia pranoi dhe e fali.” Shokët i thanë: “O Pejgamberi i Allahut, a edhe për kafshët shpërblehemi? Pejgamberi s.a.v.s. u thotë: “Për çdo gjallesë ka shpërblim.”

Përderisa për mëshirën ndaj qenit falen gabimet, atëherë çfarë shpërblimi ka për mëshirën ndaj njerëzve?!

ZOGU ME ZOGJTË E SAJ

Transmetohet nga Abdullahu r.a. se ka thënë:

“Përderisa udhëtonim me Pejgamberin s.a.v.s., për një çast Pejgamberi s.a.v.s. u ndal për të kryer një punë të tij. Ndërsa ne duke pritur pamë një zog me dy zogj të vegjël të tij. I morëm zogjtë e vegjël. Kur u kthye zogu dhe nuk i pa të vegjlit e tij, u shqetësua shumë. Në atë moment erdhi edhe Pejgamberi s.a.v.s. dhe pyeti: “Kush i shkaktoi shqetësim këtë zogu, duke ia marrë të vegjlit e saj? Kthejani zogjtë e saj, kthejani zogjtë e saj. Bëhuni të mëshirshëm ndaj saj.”

Po ashtu Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Kurrë nuk do të besoni, përderisa nuk bëheni të mëshirshëm.”

DEVEJA, E CILA KA QARË

Një ditë Pejgamberi s.a.v.s. hyri në kopshtin e një Ensari (shok të tij). Aty i afrohet deveja dhe nga sytë e saj pikonin lot. Pejgamberi s.a.v.s. me duart e tij fisnike fërkon devenë për koke, e ajo pushon së qari dhe qetësohet. Pejgamberi s.a.v.s. kërkon pronarin e devesë. Vjen një djalosh dhe i thotë: “Ajo është e imja, o Pejgamber i Allahut.” Pejgamberi s.a.v.s. i thotë:

“A nuk i frikësohesh Allahut për shkak të kësaj kafshe, që Allahu ta ka dhënë në pronësi? Ajo po më ankohet se nuk po e ushqen sa duhet dhe se po e lodh për së tepërmi, duke e ngarkuar shumë.”

MACJA

Islami nuk lejon zemërgurtësi, qoftë edhe ndaj kafshëve. Islami ua zë për të madhe atyre që nuk kujdesen për dhembjet e tyre, andaj edhe ka sqaruar se njeriu për një të keqe që ia bën kafshës hyn në xhehenem.

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Ka hyrë një grua në zjarr të xhehenemit, nga shkakut se e ka lidhur një mace dhe as nuk e ka ushqyer, as nuk e ka lënë të lirë që të hajë prej ushqimeve në tokë.”

(Buhariu)

NË XHENET DO TË HYJMË ME MËSHIRËN E ALLAHUT

Pejgamberi s.a.v.s. na ka treguar se, më herët, derisa ishte Xhibrili më ka thënë:

“O Muhamed, pasha Atë, i Cili të ka dërguar me të vërtetën dhe për vërtetësi, është një rob prej robërve të Allahut, i cili e ka adhuruar Allahun në një maje të një mali, të një ujdhesë, pesëqind vjet. Ujdhesa ka qenë e vogël tridhjetë pëllëmbë gjatësi dhe tridhjetë pëllëmbë gjerësi, ndërsa deti me gjatësi në secilën anë të ujdhesës 4000 fersah. Allahu i Lartmadhëruar ka mundësuar që në atë ujdhesë të jetë një burim uji sa gishti, i cili buronte ujë të ëmbël, i cili rridhte teposhtë, dhe aty një shegë, e cila për çdo natë jepte nga një frutë të pjekur për t’u ushqyer ditën. Kur bëhej natë zbriste dhe merrte abdest, e merrte shegën dhe e hante, pastaj i falej Zotit të Lartmadhëruar. Pastaj e ka lutur Allahun që t’ia merrte shpirtin në sexhde dhe që trupin e tij mos ta prishte toka, me qëllim që kur të ringjallet, të ringjallet duke bërë sexhde.”

Pastaj ka vazhduar të tregoj: “Ashtu edhe ka ndodhur. Dhe përderisa ne ecnim, lart e poshtë, e pamë një shenjë prej ku do të ringjallet në Ditën e Kijametit. Ai do të qëndrojë para Allahut të Lartmadhëruar dhe Zoti do të thotë: “Qojeni robin Tim në Xhenet me mëshirën Time.” Ai thotë: “O Zoti im. Me veprën time.” Zoti thotë: “Qojeni në Xhenet me mëshirën Time.” Ai thotë: “O Zoti im! Me veprën time.” Zoti thotë: “Qojeni në Xhenet me mëshirën Time.” Ai thotë: “O Zoti im! Me veprën time.”

Atëherë Zoti u thotë melekëve: “Peshojani begatitë e Mia me veprat e tij.” Kur ia masin në peshojë, shohin se vetëm shqisa e shikimit nivelizohet me adhurimin pesëqindvjeçar. Ndërsa tërë begatia tjetër e trupit të tij ishte shtesë. Dhe Zoti thotë: “Qojeni robin tim në zjarr.” Derisa e zvarritnin për në zjarr, ai thërret: “O Zoti im, me mëshirën Tënde më qo në Xhenet.” Zoti thotë: “Kthejeni.” Pasi që e kthyen qëndron para Zotit, e Zoti i thotë: “O robi Im! Kush të ka krijuar kur nuk ke qenë fare?” Ai përgjigjet: “Ti, o Zot.” Zoti i thotë: “Ti e krijove veten apo të krijova me mëshirën Time?” Zoti i thotë: “Kush të ka forcuar për adhurim pesëqindvjeçar.” Ai thotë: “Ti o Zoti im.”

SI SHPËRBLEHEN TË MËSHIRSHMIT

- Të mëshirshmit i do Allahu dhe i shpërblen me Xhenet.
- I mëshiron Allahu dhe i afron pranë Tij.
- Të mëshirshmit i donë njerëzit, iu afrohen atyre dhe kanë respekt për ta.
- I mëshirshmi i ngjason Pejgamberit s.a.v.s. në sjellje dhe shokëve të tij.

ÇKA PËRFITOJMË NGA KY LIBËR

Nga ky libër përfitojmë se:

- Cilësia e mëshirës është cilësi e Zotit të Lartmadhëruar;
- I Dërguari i Allahut ka qenë i butë dhe i mëshirshëm ndaj besimtarëve;
- Mëshira ndaj të vegjëlve e të mëdhenjve është cilësi e besimtarëve;
- Mëshira ndaj kafshëve është cilësi e besimtarëve;
- Xheneti është shpërblimi për të mëshirshmit;
- Xhehenemi është dënim për të pamëshirshmit;
- Ai i cili e ka zemrën e ngurtë nuk hyn në xhenet, sepse Allahu nuk e do zemërgurin;
- Zemërgurin nuk e duan njerëzit dhe largohen prej tij;
- Allahu nuk i mëshiron ata, të cilët nuk i mëshirojnë njerëzit.

PËRFUNDIM

Të kujtojmë hadithin “*Zoti mëshiron nga robërit e Tij ata që janë të mëshirshëm.*”

Ndërsa, kujtimi është për ata që kanë zemër, që përqendrojnë dëgjimin dhe dëshmojnë me sy të vërtetën.

Ndoshta kjo çka është e shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe e dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.